

## Projektet e Qendrës Informative të Sigurimeve

Qendra Informative e Sigurimeve, aktualisht është duke implementuar projektin e quajtur SINCRA - Sistemi i Integruar për Ciklin e Regjistrimit të Automjeteve, sistem i cili duke filluar nga Dogana e Kosovës, qendrat e automjeteve të Kosovës, kompanitë e sigurimeve dhe qendrat e regjistrimit të automjeteve, krijon një cikël, me ç`rast të dhënat e mjeteve motorike në mënyrë elektronike barten nga një institucion në tjetrin, duke eliminuar dyfishimin e të dhënave dhe shkurtimeve e procedurave gjatë procesit të regjistrimit të mjeteve motorike në Kosovë. Ky sistem, gjithashtu integron edhe të dhënat nga Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, të dhënat e të cilave do të përdoren për implementimin e sistemit "Bonus-Malus" nga kompanitë e sigurimeve, nga data 1 korrik 2013.

## Projektet e ardhshme të Qendrës Informative të Sigurimeve

Një prej tyre është krijimi i një qendre të dhënash antimashtrim, e cila do t`u ndihmojë kompanive të sigurimeve në evitimin e rasteve të mashtrimeve të mundshme gjatë kërkesave për dëmshpërblim. Në të njëjtën kohë, kjo qendër e të dhënave do të ndërlihet edhe me qendrat e byrove nacionale të Kartanit të Gjelbër dhe do të shërbejë edhe për njoftimin e policisë me informata të sakta rreth automjeteve të pasiguruara në trafik.



### Selia e Qendrës Informative të Sigurimeve:

#### Qendra Informative e Sigurimeve

Nr 34, Rr. Fehmi Agani  
Hyrja I, Kati I, Banesa nr. 15  
10000 Prishtinë

Tel. 038 227 060  
infocenter@bks-ks.org  
www.bks-ks.org



## Qendra Informative e Sigurimeve



Me themelimin e Byrosë Kosovare të Sigurimit, në bazë të Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Byroja e ka funksionalizuar Qendrën Informative të Sigurimeve.

## Roli i Qendrës Informative të Sigurimeve

Qendra Informativë e Sigurimeve, si rol primar e ka informimin e saktë të qytetarëve rreth sigurimeve në përgjithësi, duke filluar me sigurimet e detyrueshme nga autopërgjegjësia dhe duke vazhduar edhe me sigurimet e tjera vullnetare dhe sigurimin e jetës. Në veçanti, Qendra Informativë e Sigurimeve ka për detyrë që të dëmtuarve në aksidente t'u ofrojë informata të sakta se si të vijnë deri te dëmshpërblimi, duke i orientuar, si në plotësimin e dokumentacionit, e po ashtu edhe rreth kompanisë së sigurimit që do ta dëmshpërblejë. Rol sekondar i Qendrës Informative të Sigurimeve do të jetë edhe grumbullimi dhe ruajtja e informacioneve nga institucionet relevante që kanë të bëjnë me sigurinë në trafik. Me këto institucione do të shkëmbehen informata rreth doganimit, kontrollimit teknik, sigurimit dhe regjistrimit të mjeteve motorike, në mënyrë që të arrihet deri të informatat e sakta të mjeteve motorike të siguruar dhe të pasiguruara në trafik.

Roli i Qendrës Informative të Sigurimeve do të fuqizohet me anëtarësimin e Byrosë Kosovare të Sigurimit në Këshillin e Byrove për Karton të Gjelbër me seli në Bruksel, me ç'rast do të shkëmbejë informata me qendrat informative të byrove përkatëse rreth aksidenteve të ndodhura në Kosovë dhe në shtetet e tjera. Me këtë anëtarësim, Qendra Informativë e Kosovës do të ketë për synim kryesor edhe anëtarësimin në Grupin e Punës së Qendrave Informative të Sigurimeve të Këshillit të Byrove për Karton të Gjelbër.

## Funksioni i Qendrës Informative të Sigurimeve

Qendra Informativë e Sigurimeve do të funksionojë në atë mënyrë që do t'ua mundësojë qytetarëve që informatat rreth sigurimeve t'i marrin:

1) duke vizituar Qendrën Informative të Sigurimeve, ku mund të plotësojnë një formular për informatat që u nevojiten rreth një aksidenti të caktuar, nëse pala e interesuar për informata ka qenë e dëmtuar në atë aksident;

2) duke telefonuar në Qendrën Informative të Sigurimeve dhe në bazë të informatave të sakta të ofruara të informohen rreth shkaktarit të aksidentit, kompanisë së sigurimeve etj;

3) duke vizituar ueb faqen e Byrosë Kosovare të Sigurimit, në kuadertë së cilës është integruar moduli i Qendrës Informative, ku palët e aksidentuara (viktimat), në bazë të targave dhe të datës së aksidentit do të orientohen në Kompaninë e Sigurimit, e cila do ta kryejë dëmshpërblimin.

Në të tria këto raste, të gjitha informatat që u jepen palëve të aksidentuara janë në përputhje me Ligjin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Qendra Informativë e Sigurimeve, nga shkëmbimi i informatave me

Policinë e Kosovës për aksidentet e ndodhura në trafik do ta ndihmojë Zyrën e Antimashtrimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit, si dhe Kompanitë e Sigurimeve rreth evitimit të mashtrimeve të mundshme gjate kërkesave për dëmshpërblim.

Me shkëmbimin e informatave me qendrat e regjistrimit të automjeteve, Qendra Informativë e Sigurimeve do të ketë në dispozicion numrin e saktë të mjeteve motorike të pasiguruara ose të paregjistruara dhe të njëjtat informata do t'ia plasojë Policisë së Kosovës për marrjen e masave të mëtutjeshme. Qendra Informativë e Sigurimeve do ta publikojë Buletinin Statistikor rreth Sigurimeve të Detyruara nga Autopërgjegjësia, duke përfshirë edhe raportimin dhe pagesat e dëmeve nga këto sigurime. Në të ardhmen, në këto statistika do të përfshihen edhe sigurimet vullnetare dhe ato të jetës. Qendra Informativë e Sigurimeve do të mundësojë që institucionet mbikëqyrëse - Qeverisë së Kosovës, Policisë etj., të kenë informata të sakta dhe në kohë reale rreth sigurimeve të detyrueshme nga autopërgjegjësia.